



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH

Datë: 08.04.2022
Dragash

Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike
KRM “Ekoregjioni” Dragash

Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike KRM “Ekoregjioni” Dragash në mbledhjen e mbajtur me datë 06.04.2022 në përputhje me nenin 16 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-087 për “Ndërmarrjet Publike” të datës 13 Qershor 2008,

SHPLL

Konkurs për 1 (një) anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike KRM “Ekoregjioni” Dragash

Kandidatët e suksesshëm për pozitën e Anëtarit të Bordit të Ndërmarrjes Publike KRM “Ekoregjioni” Dragash, duhet të plotësojnë kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe përshtatshmërisë profesionale si vijon:

- a) Nuk është dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se ka kryer vepër penale apo civile që përfshin përgënjeshtimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhjen, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;
- b) Duhet të ketë integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mundë të ketë bërë ky person ndaj cilit do person tjetër;
- c) Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune, (nga fusha juridike ose ekonomike).
- d) Çdo person i cili aplikon për pozitën e anëtarit të bordit të drejtorit duhet të jap një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ ajo i përmbush kushtet e kualifikimit.
- e) Kandidatët për Anëtarë të Bordit të Drejtorëve i nënshtrohen procesit të intervistimit.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike KRM “Ekoregjioni” Prizren, duhet të dorëzojnë këto dokumente

- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë;
- Diplomë universitare : Juridik ose Ekonomik (e noterizuar)
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës);
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime;
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit);

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në zyren e Bordit të Drejtorëve të Ekoregjionit në Prizren.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i drejtorëve të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike KRM “Ekoregjioni” do të bëhet në bazë të nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (**nga data 08.04.2022 deri me datën 26.04.2022**).

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të merren në shqyrtim nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve.